UDHËZIM
Nr. 618, datë 23.8.2018

PËR RREGULLAT DHE PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË GJOBAVE NË AUTORITETIN KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË MINIERA

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 24, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 135/2016, "Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjitike",

UDHËZOJ:

1. Subjekti ndaj të cilit vendoset masa administrative ka të drejtën e ankimit me shkrim pranë Komisionit të Shqyrtimit të Gjobave, i ngritur pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

2. Subjekti ankimues mund të dorëzojë dorazi në zyrën e protokollit pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera ose me anë të shërbimit postar ankimin. Në ankim subjekti duhet të vërtetojë datën e marrjes së aktit administrativ, objekt i ankimit. Data e marrjes së ankimit me shkrim nga Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave do të konsiderohet data e protokollimit në institucion.

3. Ankimi me shkrim duhet të ketë bashkëngjitur dokumentacionin si më poshtë:

a) Emrin dhe adresën zyrtare të subjektit ankimues;

b) Numrin e regjistrimit të subjektit (NIPT-i);

c) Numri i lejes minerare për të cilën është vendosur masa administrative ose kopje të marrëveshjes kontraktore për të kryer punime nëntokësore në veprat hidroenergjetike;

d) Lëndën ku të përcaktohet kërkesa ankimore;

e) Arsyen e subjektit pse nuk është dakord me masën administrative dhe bazën ligjore në të cilën e mbështetet ankimimin;

f) Aktin administrativ, objekt i ankimimit;

g) Informacione në mbështetje të ankimit, si: raporte kontrolli, procesverbale, akte konstatimi etj.;

h) Çdo dokument tjetër që ankimuesi e çmon të rëndësishëm se ndihmon zgjidhjen e drejtë të çështjes;

i) Nënshkrimin e tij.

4. Në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera të ngrihet dhe të funksionojë Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave, i cili do të shqyrtojë ankesat e subjekteve për masat administrative sipas nenit 24, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 135, datë 22.12.2016 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë, emergjencat dhe shpëtimin në veprimtarinë minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjitike".

5. Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave përbëhet nga pesë anëtarë, si më poshtë:

a) Titullari i Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera – kryetar;

b) Drejtori i Drejtorisë së Inspektimit – anëtar;

c) Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit Teknik në Miniera – anëtar;

d) Përgjegjësi i Sektorit të Sigurisë dhe Mbrojtjes së Shëndetit – anëtar;

e) Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Ruajtjes së Institucionit – anëtar;

f) Drejtori i Emergjencave në AKSEM-i anëtar;

g) Përfaqësues nga ministria përgjegjëse për veprimtarinë minerare.

6. Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave mblidhet me urdhër të titullarit të institucionit (kryetarit), sa herë që kërkohet për shqyrtimin e ankimeve ndaj masave administrative të vendosura ndaj subjekteve minerare.

7. Mbledhja zhvillohet vetëm nëse janë të pranishëm shumica e anëtarëve të Komisionit të Shqyrtimit të Gjobave.

8. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative bëhet edhe me praninë e kundërvajtësit dhe inspektorit ose grupit të inspektorëve që kanë marrë vendimin për masën administrative. Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave merr masat e duhura për njoftimin me shkrim të subjektit ankimues për datën dhe orën e saktë të zhvillimit të mbledhjes për shqyrtimin e kundërvajtjes administrative.

9. Shqyrtimi i kundërvajtjes administrative mund të bëhet në mungesë të subjektit që ka ushtruar të drejtën e ankimit, kur ka marrë dijeni dhe nuk ka shkaqe justifikuese për mosparaqitje. Inspektori ose grupi i inspektorëve që kanë vendosur masën administrative nuk kanë të drejtë votimi, por vetëm të drejtë arsyetimi mbi masën administrative të vendosur.

10. Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave fillimisht verifikon kushtet formale të ankesës lidhur me:

a) Legjitimimin e ankesës;

b) Respektimin e afateve ligjore të dorëzimit të ankesës;

c) Plotësimin e elementeve të domosdoshme të ankesës.

11. Pas vlerësimit të kushteve formale të ankesës, Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave, shqyrton ankimin, vlerëson provat dhe me shumicë të thjeshtë, ka të drejtë të vendosë:

a) Mospranimin e ankimit për shkak të mungesës së njërit prej kushteve formale të saj, të përmendura në këtë udhëzim;

b) Pranimin e ankimit të subjektit, duke argumentuar shkeljet e konstatuara në zbatim të ligjit;

c) Pranimin e pjesshëm të ankimit duke argumentuar shkeljet e konstatuara në zbatim të ligjit;

d) Lënien në fuqi të aktit administrativ, duke argumentuar zbatimin e drejtë të procedurave dhe ligjshmërisë në veprime ose mosveprime.

12. Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave merr vendim me shumicë të thjeshtë. Kur votat janë të barabarta, vendos vota e kryetarit të komisionit.

13. Mbledhjet e Komisionit të Shqyrtimit të Gjobave pasqyrohet në procesverbal, i cili përmban arsyet e votimit pro dhe kundër, arsyetimet e ndryshme teknike dhe ligjore, si dhe vendimin përfundimtar të komisionit. Procesverbali nënshkruhet nga personi që e mban atë dhe të gjithë anëtarët që kanë qenë pjesëmarrës në mbledhje.

14. Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave në Autoritetin Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera shqyrton ankimin, merr vendimin dhe njofton subjektin brenda 15 ditëve, nga data e regjistrimit të ankimit.

15. Kundër vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Gjobave, subjekti ankimues mund të bëjë ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga data e marrjes në dorëzim të vendimit.

16. Ngarkohen Komisioni i Shqyrtimit të Gjobave pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera për zbatimin e këtij udhëzimi.

17. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjiknuri